



MBËSHTETUR NGA:





Raporti final

Zbatimi i projektit KAP'ECO, Komuniteti në Ambient të Pastër Ekologjik, në monitorimin e ecurisë së kontratës për pastrimin e Tiranës nga ECO Tirana, është mbështetur nga “Lëviz Albania”, “Local Democracy in Action” dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

1. Menaxhimi i mbetjeve është një nga shqetësimet më serioze të shoqërisë shqiptare dhe një faktor thelbësor për shëndetin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Ajo është bërë një çështje me rëndësi akute në zonat urbane të mbipopulluara, siç janë Tirana dhe qytetet e mëdha të vendit, si dhe në zonat turistike, duke dhënë një ndikim shumë negativ në perspektivat e zhvillimit të kësaj industrie, si një prej industrive me potencialin më të fortë në rritjen ekonomike të vendit dhe më drejtpërdrejt në përmirësimin e standardit të jetesës së banorëve nga këto zona. Pa e ekzagjeruar mund të thuhet se pastrimi i qyteteve dhe menaxhimi efektiv i mbetjeve janë një emergjencë kombëtare.
2. Kryeqyteti i vendit, Tirana, është ndër zonat ku ndotja e ambientit është në përmasa shqetësuese, kryesisht për shkak të volumeve të larta të mbetjeve të llojeve të ndryshme dhe trafikut të rënduar. Për këtë arsye, Bashkia e Tiranës ka vendosur si prioritet të saj një menaxhim më efektiv të mbetjeve, me qëllim krijimin e një ambienti të pastër për qytetarët. Si instrument i zgjedhur për adresimin me prioritet të këtij shqetësimi, bashkia ka zgjedhur krijimin e një partneriteti publik-publik, siç është ECO Tirana sh.a. ECO Tirana është një shoqëri aksionere, ku

51% e aksioneve zotërohen nga Bashkia e Tiranës dhe 49% nga [AGSM VERONA SpA](#), një nga grupet kryesore krejtësisht në pronësi publike që operon në Itali. Kompania ka filluar veprimtarinë e saj më 12 dhjetor 2016 dhe ka një site në internet (<http://www.ecotirana.com>), ku mund të gjendet pak informacion rreth saj dhe veprimtarisë që ajo kryen. Vlen të theksohet se niveli i informacionit që mund të merret prej saj është shumë i kufizuar dhe nuk krijon mundësi për njohje me aktivitetin e saj për publikun. Kompania pritët të ketë një periudhë operimi për 25 vjet, nëse pas një periudhe 18- mujore nga fillimi i veprimtarisë së saj nuk do të ketë ndonjë objeksion serioz. Vlera e veprimtarisë së firmës do të jetë 2,5 milionë euro në vit në nisjen e aktivitetit (me një shtesë 10% sapo të fillojë aktiviteti), vetëm për zonën eksperimentale ku do të operojë (zonën e kuqe) [Informacion i nxjerrë nga vendimi i Këshillit Bashkiak për krijimin e kompanisë ECO Tirana sh.a.]

3. Qëllimi i këtij projekti ishte të vlerësojë impaktin që ka pasur ECO Tirana me filozofinë e saj të re të punës në pastrimin e qyteteve, duke përmirësuar grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe ndarjen e mbetjeve që në burim, me qëllim riciklimin e mbetjeve të riciklueshme. Më posaçërisht tre ishin objektivat e paraqitur në projektpropozim: Objektivi 1: Monitorimi dhe identifikimi i problematikave të shërbimit të ofruar në pastrimin e qytetit nga kompania publike-publike ECO Tirana sh.a., me qëllim adresimin e tyre tek aktorët përkatës; Objektivi 2: Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së kryerjes së shërbimit të pastrimit për të arritur standarde të larta në shërbim të qytetarëve, si rekomandim për mirëmbatimin aktual të kontratës, si edhe në vitet në vazhdim; Objektivi 3. Rritja e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimin e pastrimit dhe rritja e përgjegjshmërisë së tyre për mbajtjen pastër të qytetit.
4. Aktivitetet kryesore të parashikuara në kuadër të këtij projekti kanë përfshirë: (a) Analizën e situatës - Vlerësimi i performancës së shërbimit të pastrimit në zonën e targetuar të Tiranës; (b) Vlerësimi i kënaqësisë së qytetarëve dhe bizneseve të zonës përkatëse; (c) Organizimi i takimeve me aktorët e përfshirë në projekt dhe monitorimi i shërbimit të ofruar nga ECO Tirana, në kuadër të respektimit të planit të aktiviteteve sipas kontratës me Bashkinë e Tiranës; (d) Dokumenti i rekomandimeve



të përgatitura nga ekspertët e përfshirë në projekt (ky dokument); dhe (e) Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve, që do të realizohet në javën e tretë të muajit shkurt.

5. Metodologjia e punës. Projekti është realizuar me vëzhgimet e kryera pranë zonës ku kompania e filloi veprimtarinë e vet, që njihet si “zona e kuqe”, e cila është pjesa e qendrës dhe Tiranës së Re (njësia bashkiake nr. 9 - zona “Don Bosko” dhe bulevardi “Zogu I” dhe njësia bashkiake nr. 5 - zona e Bllokut, Tirana e Re). Metodologjia e përdorur për analizën e situatës përmban elemente të kërkimit cilësor dhe të kërkimit sasior. Më specifikisht, vlerësimi i operimit dhe funksionit të këtij shërbimi ka konsistuar në:
 - Vlerësimin në terren i aktivitetit të kompanisë, duke përfshirë performancën e shërbimeve, burimeve njerëzore, eficiencën dhe problemet kryesore të hasura për çdo operacion, nisur nga kontrata e kompanisë.
 - Intervista me qytetarë lidhur me performancën e shërbimit të pastrimit të zonave të përcaktuara në projekt. Në këtë aktivitet janë angazhuar vullnetarisht rreth 50 studentë, aktivistë në lëvizjen mjedisore, OSHC përfaqësues të iniciativave për mbrojtjen e mjedisit.
 - Takime me stakeholders – ekspertë nga kompania, ekspertë mjedisi etj., që shpjegojnë fenomenet e hasura në terren dhe pritshmëritë e qytetarëve. (Takimi i organizuar me datën 20 dhjetor, 2017, ora 10:00 - 12:30, UET – materialet bashkëlidhur)
6. Organizimi i punës. Për të ndërmarrë një proces sa më të besueshëm me gjetje solide që të mundësojnë konkluzione të besueshme, grupi i punës që u angazhua në realizimin e projektit ka ndërmarrë një sërë aktivitete / takimesh (formale dhe informale), si dhe dy trajnime intensive me studentët e përfshirë në projekt. Më 1 qershor 2017 u zhvillua takimi i parë me gjithë kolegët e përfshirë në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave. Në këtë takim u ra dakord për modalitetet e pyetësorit, numrin e studentëve që do të përfshiheshin, profilin e studentëve, kohën në të cilën do të bëhej mbledhja e të dhënave në terren, trajnimi që do t'i ofrohej studentëve, si dhe puna që do të bëhej për përpunimin e të dhënave dhe shkrimin e raportit paraprak. Në shtator 2017 filloi faza e dytë e projektit, ku në të njëjtat njësi bashkiake dhe me thuajse të njëjtin grup studentësh u rizhvillua pyetësori për të matur ndryshimet e mundshme të perceptimit qytetar ndaj projektit të Bashkisë

së Tiranës për mbledhjen e diferencuar të plehrave. Pyetëtori ishte thujajse i njëjtë me atë të përdorur në qershor. I vetmi ndryshim ishte shtimi i një pyetjeje për të matur nëse qytetarët gjatë verës kishin ndryshuar perceptim në lidhje me projektin.

7. Diskutimi i hollësishëm i gjetjeve të projektit:

Në përfundim të punës, në total janë grumbulluar 4296 pyetësorë me qytetarët dhe janë zhvilluar 386 intervista me bizneset e ndodhura brenda zonës ku u zhvillua projekti – në fazën e parë të zhvilluar në muajin qershor 2017 dhe 4406 pyetësorë nga qytetarët në fazën e dytë të zhvilluar në muajin shtator 2017. Ndarja në dy faza ka synuar që të masë ndryshimet e perceptimit që ka komuniteti përgjatë kohës në raport me njohjen e veprimtarisë së kompanisë, impaktin e punës së saj në komunitet dhe kënaqësinë e tyre për këtë shërbim bashkiak. Në veçanti është synuar që të matet rezultati i punës gjatë një sezoni problematik, siç është sezoni i pushimeve të verës. Rezultatet e pyetësorëve dhe intervistave jepen të plota në shtojcat statistikore që i bashkëlidhen këtij raporti. Tabela më poshtë jep një përmblendhje të rezultateve të intervistave me qytetarët, duke kapur edhe elementin e dinamikës së projektit përgjatë një intervali tremujor.

Nr rendor	Permbajtja e pyetësit	%	Po	%2	Jo	
			qershor 2017	shtator 2017	qershor 2017	shtator 2017
1	Pyetja Jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka formuar Eco Tirana për pashtimin e qytetit dhe për të nisur mbledhjen e diferencuar të plehrave?	68.5	76.4	31.5	23.6	
2	Keni parë që përgatitë mugjive janë operativ mjetejt e reja (me ngjyrë të bardhë) të Eco Tirana për mbledhjen e plehrave?	65.4	71.5	34.6	28.5	
3	Keni vënë re që Eco Tirana po përdor mjetejt të reja pashtimi për mugjt?	62.5	69.4	37.5	30.6	
4	Keni vënë re që personeli i Eco Tirana (si ata në mjetejt dhe ata që pashtojnë mugjtë) veshin një uniformë profesionale?	66.4	69.4	33.6	32.7	
5	Keni parë kazanët e rinj për mbledhjen e plehrave në mënyrë të diferencuar?	73.9	73.8	26.1	26.2	
6	Në familjen tuaj keni filluar të bëni mbledhjen e diferencuar të plehrave?	43.4	59.8	56.6	40.2	
7	A e dini se cilat mbetje vëndosen në kazanët jeshile dhe cilat në kazanët blu?	57.3	64.7	42.7	35.3	
8	A mendoni se fenomenet i mbledhësve abuziv të plehrave që gjëmojnë nëpër kazane duhet eliminuar?	66.6	71.9	33.4	28.1	
9	Ju i zvogëltoni përmasat e kartonave dhe të shisheve plastike para se ti vëndosni në kazan?	60.8	66.1	39.2	33.9	
10	Keni vënë re që kazanët e rinj për grumbullimin e plehrave (të pajsur me kapak) lënë dhe diellkshen?	40.1	54.5	59.4	45.5	
11	A i vlerësoni pozitivisht mugjt e parë të shërbimit të Eco Tirana?	75.9	73.7	24.1	26.3	

Siç duket nga tabela, në të gjitha dimensionet me të cilat ne kemi matur njohjen e projektit, ndikimin që ka projekti në qytet dhe kënaqësinë e qytetarëve në raport me punën e ECO Tirana, rezultatet janë përgjithësisht pozitive dhe perceptimet në vijimësi kanë ardhur në përmirësim të dukshëm. Kjo do të thotë se projekti po gjen gjithnjë e më shumë përkrahës në komunitet dhe se ndikimi i tij në përmirësimin e shërbimit të pastrimit të qytetit është domethënë.



Në vijim po shtjellojmë në mënyrë më analitike disa nga gjetjet më të rëndësishme të këtij projekti.


Të dhënat e përftuara nga përgjigjet u grupuan në tri grupe mbi të cilat bazohet edhe analiza: (a) shkalla e informimit të qytetarëve dhe bizneseve lidhur me veprimtarinë e ECO Tirana; (b) rëndësinë ose vlerësimin e tyre mbi impaktin e veprimtarisë së kompanisë në komunitet dhe (c) matjen e kënaqësisë së aktorëve taksapagues për këtë shërbim që Bashkia e Tiranës po e ofron në një format të ri, sipas një partneriteti publik-publik.

A. Informacioni që kanë qytetarët për kompaninë ECO Tirana. Në këtë kategori u përpunuan përgjigjet e qytetarëve ndaj këtyre pyetjeve:

1. Jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka krijuar ECO Tirana për pastrimin e qytetit dhe për të nisur mbledhjen e diferencuar të plehrave?
2. Keni parë që përgjatë rrugëve janë operative mjetet e reja (me ngjyrë të bardhë) të ECO Tirana për mbledhjen e plehrave?
3. Keni vënë re që ECO Tirana po përdor mjete të reja pastrimi për rrugët?
4. Keni vënë re që personeli i ECO Tirana (si ata në mjete dhe ata që pastrojnë rrugët) veshin një uniformë profesionale?
5. I keni parë kazanët e rinj për mbledhjen e plehrave në mënyrë të diferencuar?
6. Keni vënë re që kazanët e rinj për grumbullimin e plehrave (të pajisur me kapak) lahen dhe dezinfektohen?

Të dhënat tregojnë se qytetarët i njohin të paktën disa nga dimensionet e projektit të Bashkisë Tiranë. Lajmi pozitiv është se ka një rritje domethënëse të qytetarëve që e njohin shumë mirë këtë projekt dhe u janë përgjigjur “Po” të gjashta pyetjeve mbi nivelin e informacionit që kanë për këtë projekt, pothuajse një dyfishim i tyre.

Krahasoni i rezultateve për dy fazat për variablin Informacioni



Pavarësisht këtij zhvillimi pozitiv, duhet pasur kujdes, sepse vihet re që numri i qytetarëve që janë pak të informuar (që njohin nga 0 në 3 dimensione të projektit) është rritur. Pra duhet bërë një punë më e mirë me këtë grup, që është dhe më i vështiri për t'u arritur me mjete tradicionale komunikimi, pasi ka gjasa që të ndjekin pak lajme apo të kenë besim të cunguar te mediumet informative. Duket se me një grup të gjerë të qytetarëve projekti po e humbet “prekjen” e vet.

Nga intervistat me bizneset e zonës ku u pilotua projekti, gjithashtu rezultojnë se: 66% e bizneseve kanë informacion të bollshëm rreth shërbimeve të ECO Tirana, 15% kanë informacion të plotë dhe 20% kanë informacion të cunguar. Treguesit janë të përafërt edhe ndër intervistuesit nga popullata. Për shembull, 68% e të intervistuarve pohojnë se kanë dijeni se bashkia ka nisur grumbullimin e mbetjeve të diferencuara.

Në përgjithësi mund të thuhet se njohja e komunitetit, qytetarëve dhe bizneseve me punën e ECO Tirana është në nivele të kënaqshme. Sidoqoftë, segmente të caktuara të popullatës janë jashtë vëmendjes dhe nuk kanë arritur “të preken” nga ky projekt. Kjo nënkupton që kompania dhe njësitë bashkiake duhet të gjejnë mënyra që të arrijnë te këto segmente të popullatës, ndoshta duke eksperimentuar mënyra të ndryshme të komunikimit. Ky segment që mund të variojë midis 20 - 30% të popullatës, është një segment i gjerë dhe që ka ndikim të dukshëm në efektivitetin e punës së kompanisë.

Disa nga çështjet e rëndësishme që lidhen me operimin e projektit janë problematike dhe jo fort të njohura nga publiku. Për shembull, megjithëse në përgjithësi qytetarët e dallojnë vendosjen e kazanëve të rinj, uniformat e reja të stafit dhe makinat e reja të pastrimit, ata kanë shumë pak informacion se si duhet bërë ndarja e mbetjeve në shtëpi përpara se të hidhen dhe se në cilët kazanë t'i vendosin ato, siç do të analizohet edhe në vijim. Gjysma e të intervistuarve nuk janë në dijeni se firma ka vendosur shërbim të posaçëm për tërheqjen e ambalazheve drejtpërdrejtë nga bizneset. Puna me bizneset dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me këtë komunitet është më lehtësisht i arritshëm dhe kompania duhet të intensifikojë komunikimin me ta, me synim rritjen e eficiencës së punës së saj.




B. Impakti që ka pasur ky shërbim te qytetarët

Në këtë kategori u përpunuan përgjigjet e qytetarëve ndaj këtyre pyetjeve:

- 1) Në familjen tuaj keni filluar të bëni mbledhjen e diferencuar të plehrave?
- 2) A e dini se cilat mbetje vendosen në kazanët jeshilë dhe cilat në kazanët blu?
- 3) A mendoni se fenomeni i mbledhësve abuzivë të plehrave që gërmojnë nëpër kazanë duhet eliminuar?
- 4) Ju i zvogëloni përmasat e kartonëve dhe të shisheve plastike para se t'i vendosni në kazan?

Të dhënat na japin një panoramë mikse. Tabela më poshtë tregon ndryshimet midis dy fazave të pyetësorit.



Në fazën e parë të projektit rezulton se vetëm 43% e të intervistuarve besonin se projekti i pastrimit të qytetit kishte një impakt domethënës në krijimin e një ambienti të pastër në komunitet. Ndërkohë, me kalimin e kohës një pjesë e atyre që ishin më skeptikë dhe që ishin vetëm pjesërisht të bindur në impaktin pozitiv të projektit, janë bërë me optimistë. Por edhe grupi i qytetarëve që besojnë se projekti nuk ka impakt, edhe pse një grup relativisht i vogël, gati një në dhjetë persona, është rritur.

Në shkencat sociale fenomene të tilla janë vënë re më parë dhe janë shqetësuese. Po krijohet një perceptim i shtresëzuar i projektit ku ata që besonin që në fillim e besojnë gjithmonë e më shumë dhe ata që e kishin me dyshim që në fillim e besojnë gjithmonë e më pak e si rrjedhojë nuk e ndryshojnë sjelljen e tyre. Kjo do të thotë që metodat tradicionale për të përhapur informacion do të rrisin mbështetje tek ato grupe ku ekziston ky predispozicion pozitiv dhe me shumë gjasa do të kenë pak impakt te grupet të cilat projekti nuk ka pasur efektin e pritur. Prandaj dhe duhen gjetur mekanizma të ndryshëm për të arritur këtë target grup.

Ndërsa biznesi është shprehur më pesimist se popullata. Nga intervistat rezulton se ndërsa 45.6% e bizneseve shprehen se shërbimet e ECO Tirana kanë pasur shumë impakt në punën e tyre, 25% shprehen se nuk ka pasur impakt fare, me një diferencë prej më shumë se tri herësh krahasuar me qytetarët. Duket se projekti nuk ka arritur të krijojë sinergji bashkëpunimi me një prej aktorëve më të rëndësishëm që kontribuon në ndotjen e qytetit, siç janë bizneset e shërbimeve. Por potenciali për të krijuar më shumë komunikim me këtë komunitet që është me ndikim të fortë është gjithashtu i madh. Për shembull, rreth 40% e bizneseve nuk e dinë të dallojnë se cilat mbetje hidhen në kazanët jeshilë apo të verdhë. Situata është e ngjashme dhe me popullatën: vetëm rreth 43% e qytetarëve e bëjnë ndarjen e mbetjeve në shtëpi, ndërsa rreth 57% nuk e bëjnë ndarjen e mbetjeve. Duke qenë se kazanët kanë një formë të tillë që nevojitet një përgatitje e mbetjeve përpara se të hidhen, intervistat tregojnë se pothuajse gjysma e tyre nuk i përgatisin mbetjet në ambientet e punës që të hidhen lehtësisht në kazanët e vendosur në pikat e grumbullimit. Ky është një handicap i fortë për të rritur impaktin e projektit, pasi dhe qëllimi kryesor është grumbullimi i diferencuar i mbetjeve që në burim.

Duke qenë se bizneset janë një segment tregu më kollaj i arritshëm dhe me impakt të madh në projekt, duhet që komunikimi i kompanisë me këta operatorë të jetë shumë më intensiv. Besojmë se kjo do të ketë një kosto shumë efektive dhe me një impakt shumë të fortë në efektivitetin e punës së kompanisë.

Një tjetër aspekt shumë shqetësues i veprimtarisë së kompanisë është fakti se publiku mbetet kritik ndaj pastërtisë së vetë logjistikës që përdor firma për kryerjen e veprimtarisë së saj. Për shembull, rreth 2/3 e të intervistuarve nuk kanë parë se kazanët pastrohen dhe se zona dezinfektohet rregullisht.




C. Kënaqësia e marrë nga ky shërbim

Në këtë kategori u përpunuan përgjigjet e qytetarëve ndaj këtyre pyetjeve:

1) A i vlerësoni pozitivisht muajt e parë të shërbimit të ECO Tirana?


Të dhënat tregojnë se edhe pse ka një rënie të lehtë në fazën e dytë, qytetarët vazhdojnë të jenë masivisht të kënaqur nga shërbimi.

Krahasimi i rezultateve për dy fazat për variablin **Kënaqësia**



Së fundmi, niveli i kënaqshmërisë qëndron i lartë edhe kur qytetarëve u kërkohet të krahasojnë shërbimin e ECO Tirana me atë të pak muajve më parë. Siç tregon edhe grafiku më poshtë, qytetarët, në masë dërmuese, vërejnë përmirësime.

Përmirësimi i shërbimit



Gjithsesi kjo kënaqshmëri nuk është reflektuar në mënyrën e ndarjes së mbetjeve në burim, siç u tregua dhe në analizën e impaktit.

Edhe komuniteti i biznesit është shprehur i kënaqur nga shërbimi që ofron ECO Tirana. Shumica dërmuese e tyre, 80%, shprehen se shërbimi që ofron ECO Tirana është shumë i rëndësishëm për ta. Gjë që do të thotë se kanë edhe një ndjeshmëri të lartë ndaj këtij shërbimi dhe problematikave të mundshme që e shoqërojnë atë.

Pavarësisht problematikave me informacionin apo impaktin e shërbimit, 84% e bizneseve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin e ECO Tirana, por vetëm 4 ndër 10 biznese janë të gatshme të paguajnë tarifë shtesë për më shumë shërbime.

Analiza cilësore

1. Metodologjia e vlerësimit të veprimtarisë së ECO Tirana kishte parashikuar edhe një analizë cilësore të kontratës që është nënshkruar midis partnerëve, Bashkisë Tiranë dhe [AGSM VERONA SpA](#). Qëllimi ishte që të ndriçoheshin aspektet teknike dhe financiare të kësaj sipërmarrjeje dhe të hidhej sa më shumë transparencë mbi efektivitetin e përdorimit të parave të qytetarëve taksapagues të Tiranës. Në analizën e fundit, cilësimet si qytetar “i kënaqur” apo “i pakënaqur”, “shërbim perfekt apo i mangët” etj., duhen parë në raport me sa paguajnë më shumë qytetarët për të njëjtin shërbim. Një punë realisht efektive do të ishte ajo kur me të njëjtën pagesë, qytetarët marrin një shërbim më cilësor, ndërsa nëse qytetarët paguajnë më shumë, edhe pritshmëritë për një shërbim më të mirë janë normale. Për këtë arsye, ne i jemi drejtuar zyrtarisht edhe Bashkisë Tiranë dhe kompanisë ECO Tirana për të na vënë në dispozicion një kopje të kontratës, mbi të cilën është krijuar dhe operon kompania. Fatkeqësisht, nga asnjëra palë nuk na është mundur analiza ekonomike dhe juridike e kontratës. Prandaj dhe nuk kemi qenë në gjendje të bëjmë një vlerësim të eficiencës, me të cilën është realizuar ky shërbim publik, siç është pastrimi i Tiranës. I vetmi informacion i disponueshëm publikisht është vendimi i Këshillit Bashkiak mbi krijimin e kompanisë.



2. Analizës cilësore i shërbeu edhe takimi që u zhvillua me aktorët e përfshirë në proces, siç ishin shoqatat e ricikluesve, ambientalistët, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të bashkisë. Nga ky takim u nënvizuan një numër problemesh shqetësuese, duke cilësuar se pavarësisht përmirësimeve që janë shënuar nga operimi i ECO Tirana, **realiteti** mbetet **jofunksional**, i pandryshuar në kuptimin e konceptit për një menaxhim të integruar të mbetjeve. Zgjidhjet e pjesshme, edhe pse mund të jenë modele pozitive në një shkallë të vogël, është e vështirë që të ndryshojnë në mënyrë rrënjësore situatën e rënduar në të cilën ndodhet mjedisi shqiptar, nëse përmirësimi nuk shtrihet në të gjitha hallkat e zinxhirit: që nga ndotësi, grumbullimi, ndarja, transportimi, riciklimi dhe asgjësimi total i mbetjeve. I gjithë **procesi** i deritanishëm u nënvizua që ka qenë **jo transparent**, një fakt i nënvizuar edhe nga një anëtar i Këshillit Bashkiak, që ishte prezent në tryezën e diskutimit; i bërë pa konsultime me aktorët dhe palët e interesuar dhe në kushtet e mangësive të kuadrit ligjor dhe nënligjor. Siç e theksuam dhe më lart, fakti që asnjëri nga partnerët e ECO Tirana nuk na mundësoi vënien në dispozicion të kontratës dhe manualit të punës së kompanisë, përfshirë standartet e organizimit të brendshëm të punës, dëshmon për një mungesë gatishmërie për të qenë transparent me publikun, edhe pse publiku është punëdhënësi i kompanisë.
3. Pjesëmarrësit në tryezën e diskutimit ofruan si alternativë që menaxhimi i mbetjeve duhet të zhvillohet sipas një skeme kombëtare, ku duhen përfshirë si autoritetet lokale, shoqatat e ricikluesve dhe sektori privat në tërësi. Në çdo rast, mendojmë se shoqatat e ricikluesve mund të përfshihen si aksionerë së bashku me ndërmarrjet e pastrimit të qytetit, në mënyrë që menaxhimi i mbetjeve të qyteteve të mos reduktohet thjesht në pastrimin, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në landfields. Kjo mënyrë e administrimit të mbetjeve, duke mbajtur industritë ricikluese jashtë procesit, nuk ndihmon në riciklimin e mbetjeve të riciklueshme, që janë një vepërimtari ekonomike me rëndësi të veçantë në kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ekonomizimit të lëndëve të para natyrore.

4. Procesi i buxhetimit të fondeve publike duke alokuar fonde në ndërtimin e inceneratorëve, që janë hallka e fundit e procesit të menaxhimit, përveçse ka krijuar një situatë ku investimet në këto impiante janë në kapacitete përpunuese disa herë më të larta sesa prodhohen, ka minuar edhe industrinë e riciklimit. Praktikisht bashkitë demotivohen të ndajnë mbetjet në burim dhe të kalojnë për djegie vetëm mbetjet e pariciklueshme. Inceneratori i ndërtuar në Elbasan që nga muaji prill 2017, akoma është jashtë funksionit, ose në periudhë kolaudimi. Ligji i menaxhimit të integruar të mbetjeve vendos si prioritet riciklimin dhe detyron autoritetet vendore që të bëjnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve deri në fund të vitit 2018 - të këtij viti! Duhet nënvizuar sërish që praktikatat e aprovimit dhe ndërtimit të inceneratorëve kanë qenë në shkelje të hapur të kërkesave ligjore dhe standardeve ligjore për transparencën e procesit, konsultimin publik dhe përfshirjen e komuniteteve në këtë proces, por edhe të rregullave të konkurrencës në garën për dhënien e koncesioneve.

5. Taksa e ambalazhit, së bashku me taksat dhe tarifat e tjera me destinacion ruajtjen e mjedisit që qytetarët paguajnë në pushtetin lokal dhe qendror, mund të grumbullohen në një Fond Kombëtar të Mjedisit, i cili do të shërbente edhe si një instrument financiar për të mbështetur veprimtarinë e një pushteti vendor në menaxhimin e mbetjeve. Mendimi ynë është se krijimi i një Fondi Kombëtar për Mjedisin mund të ishte një projekt feasible i Ministrisë së Mjedisit, duke operuar brenda programit buxhetor të kësaj ministrie, dhe jo si një fond më vete. Projekti mund të funksionojë ngjashmërisht me Fondet e Konkurrueshmërisë që administrojnë Ministria e Ekonomisë apo projektet e mbështetjes për bujqësinë etj.



Përfundime dhe rekomandime

1. Në tërësi projekti pilot i Bashkisë Tiranë për trajtimin dhe mbledhjen e diferencuar të mbetjeve në njësitë bashkiake nr. 5 dhe nr. 10 njihet në masë të kënaqshme nga qytetarët, të cilët janë të kënaqur nga projekti. Por impakti i projektit deri tani mbetet i dobët, duke gjykuar nga fakti se shumë pak njihet dhe respektohet ndarja e mbetjeve që në burim, si nga qytetarët ashtu dhe nga bizneset. Po ashtu, edhe përmirësimi i higjienës në pikat e hedhjes së mbetjeve është problematik.
2. Faza e dytë e intervistave tregoi se ka një rritje të impaktit të projektit dhe të informacionit mbi të. Duket se forca e zakonit dhe “tërheqja” e sjelljeve të vjetra e të ngulitura në mendje është e tillë që po e vështirëson penetrimin e projektit në përditshmërinë e sjelljes qytetare në lidhje me trajtimin e plehrave që ata prodhojnë. Kjo do të thotë se qytetarët duhen kujtuar vazhdimisht për benefitet e projektit dhe rolin të tyre në suksesin e tij. Duhet punuar më mirë me grupet, të cilat janë jo aktive në komunitet e që janë më pak besues ndaj mjeteve tradicionale të informacionit. Grupet apatike janë më të vështirë për t’u ndryshuar, por edhe më të rëndësishmit për këtë projekt. Nëse vazhdohet që të kënaqurit të kënaqen më shumë dhe apatikët të bëhen akoma më shumë të tillë, projekti nuk do t’i përbushë objektivat e tij.
3. Elemente të rëndësishme të projektit që mund të shënojnë një rritje të impaktit të tij, mbeten të pazhvilluar. Qytetarët dhe bizneset kanë njohje të paktë për ndarjen e mbetjeve dhe në pjesën më të madhe kjo nuk kryhet. Po kështu edhe bizneset nuk kanë dijeni për shërbime që ofrohen për tërheqjen e ambalazheve apo çdo shërbim tjetër të ri që mund të ofrojë kompania në të ardhmen.
4. Qytetarët janë shumë kritikë për higjienën e infrastrukturës grumbulluese: larjen e kazanëve, dezinfektimin dhe rregullaritetin e ofrimit të shërbimit. Disa shqetësime dhe sugjerime të marra nga qytetarët janë:

- Pastrimi të bëhet disa herë gjatë ditës
 - Pastrimi të bëhet gjatë natës
 - Të shtohen mjetet e informimit
 - Të shtohet numri i kazanëve dhe i punonjësve të pastrimit
 - Kazanët të lahen më shpesh, sidomos gjatë verës etj.
5. Shoqata dhe industria ricikluese ka mbetur jashtë vëmendjes, e përfshirë dhe e pakonsultuar. Mënyra se si është operuar përbën në fakt një devijim nga objektivi kryesor që kërkon ligji i menaxhimit të integruar të mbetjeve, ku riciklimi duhet të jetë objektivi parësor. Në fakt, grumbullimi dhe transportimi direkt në landfill në këtë formë, është i përshtatshëm vetëm për dërgimin e tyre në inceneratorët për djegie. Kjo mënyrë e përcaktimit të prioritetëve buxhetore nga pushteti vendor duke alokuar buxhete për ndërtim të impianteve të asgjësimit të mbetjeve, por pa targetuar më së pari përgatitjen e mbetjeve për industritë e riciklimit, është një qasje e gabuar dhe duhet të rishikohet. Një gjë e tillë bie ndesh me prioritetet që vetë ligji ka përcaktuar, me interesat e ekonomisë në tërësi dhe kundër objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
 6. Firma dhe bashkia duhet të bëjnë transparente gjithçka që lidhet me zbatimin e këtij projekti. Standardet dhe manualët e organizimit të punës duhet të jenë të hapura, duhet të ketë transparencë financiare në raport me të ardhurat dhe shpenzimet e kompanisë etj.
 7. Një proces konsultimi i përhershëm duhet të zhvillohet me industritë e qytetit, në veçanti me industritë e riciklimit, në mënyrë që të gjenden modalitetet më të përshtatshme për të përfshirë këtë grup të rëndësishëm interesi në këtë proces.
 8. Ministria e Mjedisit duhet të ndërtojë një projekt për “Qytete të pas-tra”, në mënyrë që të mbështesë nismat e bashkive për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe menaxhimin e mbetjeve në nivel kombëtar. Kjo do të ndikonte në rritjen e gatishmërisë së qytetarëve për të paguar taksat dhe tarifat në këmbim të një qyteti më të pastër dhe një shërbimi më të mirë publik.



Apendiks: Rezultatet e pyetësorëve dhe intervistave me bizneset

Bizneset – Qershor 2017 **Gjithsej 386 intervista**


Sqaroj se janë 17 pyetje, nga të cilat 16 me përgjigje po ose jo dhe një pyetje e hapur.

Më poshtë janë rezultatet për 16 pyetjet me alternativë po ose jo.

Pyetja 1

Jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka krijuar ECO Tirana për pastrimin e qytetit dhe për të nisur mbledhjen e diferencuar të plehrave?

Pyetja 1				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	294	76.2	76.2	76.2
Valid jo	92	23.8	23.8	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 2

Mendoni se partneriteti publik – privat për menaxhimin e plehrave është zgjedhja e duhur?

Pyetja 2

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid po	283	73.3	73.3	73.3
jo	103	26.7	26.7	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 3

Keni parë që përgjatë rrugëve janë operative mjetet e reja (me ngjyrë të bardhë) të ECO Tirana për mbledhjen e plehrave?

Pyetja 3

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid po	310	80.3	80.3	80.3
jo	76	19.7	19.7	100.0
Total	386	100.0	100.0	






Pyetja 4

Keni vënë re që ECO Tirana përdor mjete të reja pastrimi për rrugët?

Pyetja 4

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	271	70.2	70.2	70.2
Valid jo	115	29.8	29.8	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 5

Keni vënë re që personeli i ECO Tirana (si ata në mjete dhe ata që pastrojnë rrugët) veshin një uniformë profesionale?

Pyetja 4

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	271	70.2	70.2	70.2
Valid jo	115	29.8	29.8	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 6

A është e rëndësishme kjo për ju?

Pyetja 6

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	324	83.9	83.9	83.9
Valid jo	62	16.1	16.1	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 7

Mendoni që imazhi i dhënë nga mjetet e reja të përdorura nga ECO Tirana dhe uniformat e personelit e kanë përmirësuar imazhin e qytetit?

Pyetja 7

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	309	80.1	80.1	80.1
Valid jo	77	19.9	19.9	100.0
Total	386	100.0	100.0	






Pyetja 8

I keni parë kazanët e rinj për mbledhjen e plehrave në mënyrë të diferencuar?


Pyetja 8				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	325	84.2	84.2	84.2
Valid jo	61	15.8	15.8	100.0
Total	386	100.0	100.0	



Pyetja 9

A e dini se cilat mbetje vendosen në kazanët jeshilë dhe cilat në kazanët blu?

Pyetja 9				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	237	61.4	61.4	61.4
Valid jo	149	38.6	38.6	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 10

Ju i zvogëlioni përmasat e kartonëve dhe të shisheve plastike para se t'i vendosni në kazan?

Pyetja 10

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	230	59.6	59.6	59.6
Valid jo	156	40.4	40.4	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 11

Keni vënë re që kazanët e rinj për grumbullimin e plehrave (të pajisur me kapak) lahen dhe dezinfektohen?

Pyetja 11

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	130	33.7	33.7	33.7
Valid jo	256	66.3	66.3	100.0
Total	386	100.0	100.0	






Pyetja 12

A mendoni se fenomeni i mbledhësve abuzivë të plehrave që gjëmojnë nëpër kazanë duhet eliminuar?


Pyetja 12				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	296	76.7	76.7	76.7
Valid jo	90	23.3	23.3	100.0
Total	386	100.0	100.0	



Pyetja 13

Në disa rrugë të qytetit ECO Tirana ka vendosur një shërbim specifik për grumbullimin e ambalazheve (kartonë, plastikë, kanoçe) drejtpërsëdrejti nga bizneset. Jeni në dijeni?

Pyetja 13				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	201	52.1	52.1	52.1
Valid jo	185	47.9	47.9	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 14

Ky shërbim, sipas jush, është i dobishëm për të shmangur mbushjen e kazanëve të rrugës dhe për të shmangur që mbetjet e riciklueshme të merren abuzivisht?

Pyetja 14

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	300	77.7	77.7	77.7
Valid jo	86	22.3	22.3	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetja 15

A i vlerësoni pozitivisht muajt e parë të shërbimit të ECO Tirana?

Pyetja 15

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	297	76.9	76.9	76.9
Valid jo	89	23.1	23.1	100.0
Total	386	100.0	100.0	






Pyetja 16

Do të ishit të gatshëm që për një shërbim edhe më të mirë të bashkisë të paguanit një tarifë më të lartë?

Pyetja 16				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	163	42.2	42.2	42.2
Valid jo	223	57.8	57.8	100.0
Total	386	100.0	100.0	




Pyetësoni me qytetarët – Qershor 2017

Gjithsej 4406 pyetësorë

Pyetja 1

Jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka krijuar ECO Tirana për pastrimin e qytetit dhe për të nisur mbledhjen e diferencuar të plehrave?


Qytetari 1				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	3016	68.5	68.5	68.5
Valid jo	1390	31.5	31.5	100.0
Total	4406	100.0	100.0	



Pyetja 2

Keni parë që përgjatë rrugëve janë operative mjetet e reja (me ngjyrë të bardhë) të ECO Tirana për mbledhjen e plehrave?

Qytetari 2				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2883	65.4	65.4	65.4
Valid jo	1523	34.6	34.6	100.0
Total	4406	100.0	100.0	






Pyetja 3

Keni vënë re që ECO Tirana po përdor mjete të reja pastrimi për rrugët?

Qytetari 3

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2752	62.5	62.5	62.5
Valid jo	1654	37.5	37.5	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 4

Keni vënë re që personeli i ECO Tirana (si ata në mjete dhe ata që pastrojnë rrugët) veshin një uniformë profesionale?

Qytetari 4

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2925	66.4	66.4	66.4
Valid jo	1481	33.6	33.6	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 5

I keni parë kazanët e rinj për mbledhjen e plehrave në mënyrë të diferencuar?

Qytetari 5

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	3255	73.9	73.9	73.9
Valid jo	1151	26.1	26.1	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 6

Në familjen tuaj keni filluar të bëni mbledhjen e diferencuar të plehrave?

Qytetari 6

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	1913	43.4	43.4	43.4
Valid jo	2493	56.6	56.6	100.0
Total	4406	100.0	100.0	






Pyetja 7

A e dini se cilat mbetje vendosen në kazanët jeshilë dhe cilat në kazanët blu?

Qytetari 7

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2525	57.3	57.3	57.3
Valid jo	1881	42.7	42.7	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 8

A mendoni se fenomeni i mbledhësve abuzivë të plehrave që gjëmojnë nëpër kazanë duhet eliminuar?

Qytetari 8

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2934	66.6	66.6	66.6
Valid jo	1472	33.4	33.4	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 9

Ju i zvogëlioni përmasat e kartonëve dhe të shisheve plastike para se t'i vendosni në kazan?

Qytetari 9

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	2679	60.8	60.8	60.8
Valid jo	1727	39.2	39.2	100.0
Total	4406	100.0	100.0	




Pyetja 10

Keni vënë re që kazanët e rinj për grumbullimin e plehrave (të pajisur me kapak) lahen dhe dezinfektohen?

Qytetari 10

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	1766	40.1	40.1	40.1
Valid jo	2640	59.9	59.9	100.0
Total	4406	100.0	100.0	






Pyetja 11

A i vlerësoni pozitivisht muajt e parë të shërbimit të ECO Tirana?

Qytetari 11				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
po	3345	75.9	75.9	75.9
jo	1061	24.1	24.1	100.0
Total	4406	100.0	100.0	



Rezultati nga pyetësorët e bërë me qytetarët e intervistuar në zonat pilot në shtator 2017


Gjithsej 4296 pyetësorë

Pyetja 1

Jeni në dijeni që Bashkia e Tiranës ka krijuar ECO Tirana për pastrimin e qytetit dhe për të nisur mbledhjen e diferencuar të plehrave?

Qytetark1

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	3280	76.4	76.4	76.4
Valid Jo	1016	23.6	23.6	100.0
Total	4296	100.0	100.0	




Pyetja 2

Keni parë që përgjatë rrugëve janë operative mjetet e reja (me ngjyrë të bardhë) të ECO Tirana për mbledhjen e plehrave?

Qytetark2

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	3071	71.5	71.5	71.5
Valid Jo	1225	28.5	28.5	100.0
Total	4296	100.0	100.0	






Pyetja 3

Keni vënë re që ECO Tirana po përdor mjete të reja pastrimi për rrugët?


Qytetark3				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2982	69.4	69.4	69.4
Valid Jo	1314	30.6	30.6	100.0
Total	4296	100.0	100.0	



Pyetja 4

Keni vënë re që personeli i ECO Tirana (si ata në mjete dhe ata që pastrojnë rrugët) veshin një uniformë profesionale?

Qytetark4				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2892	67.3	67.3	67.3
Valid Jo	1404	32.7	32.7	100.0
Total	4296	100.0	100.0	




Pyetja 5

I keni parë kazanët e rinj për mbledhjen e plehrave në mënyrë të diferencuar?

Qytetark5

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	3169	73.8	73.8	73.8
Valid Jo	1127	26.2	26.2	100.0
Total	4296	100.0	100.0	




Pyetja 6

Në familjen tuaj keni filluar të bëni mbledhjen e diferencuar të plehrave?

Qytetark6

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2568	59.8	59.8	59.8
Valid Jo	1728	40.2	40.2	100.0
Total	4296	100.0	100.0	






Pyetja 7

A e dini se cilat mbetje vendosen në kazanët jeshilë dhe cilat në kazanët blu?


Qytetark7				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2781	64.7	64.7	64.7
Valid Jo	1515	35.3	35.3	100.0
Total	4296	100.0	100.0	



Pyetja 8

A mendoni se fenomeni i mbledhësve abuzivë të plehrave që gjëmojnë nëpër kazanë duhet eliminuar?

Qytetark8				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	3090	71.9	71.9	71.9
Valid Jo	1206	28.1	28.1	100.0
Total	4296	100.0	100.0	




Pyetja 9

Ju i zvogëlioni përmasat e kartonëve dhe të shisheve plastike para se t'i vendosni në kazan?

Qytetark9

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2840	66.1	66.1	66.1
Valid Jo	1456	33.9	33.9	100.0
Total	4296	100.0	100.0	




Pyetja 10

Keni vënë re që kazanët e rinj për grumbullimin e plehrave (të pajisur me kapak) lahen dhe dezinfektohen?

Qytetark10

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2340	54.5	54.5	54.5
Valid Jo	1956	45.5	45.5	100.0
Total	4296	100.0	100.0	






Pyetja 11

A i vlerësoni pozitivisht muajt e parë të shërbimit të ECO Tirana?

Qytetark11

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	3165	73.7	73.7	73.7
Valid Jo	1131	26.3	26.3	100.0
Total	4296	100.0	100.0	



Pyetja 12

A keni vënë re përmirësime të shërbimeve gjatë dy-tre muajve të fundit?

Qytetark12

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	2928	68.2	68.2	68.2
Valid Jo	1368	31.8	31.8	100.0
Total	4296	100.0	100.0	

